



## HISTORIA E PARLAMENTARIZMIT NË MAQEDONI

*Kushtetuta e Republikës sovrane dhe të pavarur të Maqedonisë është miratuar më 17 nëntor 1991. Sipas Kushtetutës Maqedonia është shtet me demokraci parlamentare, ndërsa pushteti shtetëror është i ndarë në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës. Kuvendi është njëdhomësh dhe sipas Kushtetutës të vitit 1991 mund të përbëhet nga 120 deri në 140 deputetë. Deputetët zgjidhen në zgjedhje të lira dhe të drejtpërdrejta me votim të fshehur, ndërsa mandati i tyre është i lirë dhe zgjat 4 vite.*

*Themelet historike të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë janë vendosur me Republikën e Krushevës nga viti 1903 dhe në KAÇKM-në nga viti 1944, ndërliidhen me Kuvendin Popullor të RPM-së nga viti 1946 dhe Kuvendi i RSM-së nga viti 1963 dhe 1974.*

*Në pasqyrën e dhënë më poshtë janë paraqitur ndodhitë më të rëndësishme historike dhe datat, të cilat e karakterizojnë zhvillimin modern të parlamentarizmit të Maqedonisë.*

**2 gusht viti 1903.** - Në këtë datë ka ngjarë Kryengritja e Ilindenit për çlirimin e popullit maqedonas nga pushteti osman. Më 3 gusht, pas çlirimit të Krushevës, ka filluar konstituimi i pushtetit të ri revolucionero-demokratik popullor, që në historiografi njihet si Republika e Krushevës, e cila ka zgjatur 10 ditë. Për zgjedhje më demokratike të organeve të pushtetit është konvokuar Kuvendi i përbërë nga 60 qytetarë më të dalluar, përfaqësues të të gjitha grupeve etnike në qytetin e Krushevës (maqedonas, shqiptarë dhe vllah) dhe si i tillë ka pasur funksionin e një lloji të organit përfaqësues parlamentar. Kuvendi ka zgjedhur Qeveri ekzekutive të përkohshme gjashtë anëtarëshe. Idetë e avancuara të revolucionerëve, dëshirat për bashkëjetesë, barazia e kombësive për pajtim vëllazëror dhe unitet kundër despotizmit turk (osman) janë të pasqyruara në Manifestin e Republikës së Krushevës. Manifesti i Republikë së Krushevës është njëri ndër dokumentet më të rëndësishëm në historinë e lëvizjes maqedonase për liri nacionale. Edhe pse Republika e Krushevës ka ekzistuar vetëm dhjetë ditë, ajo zë vend të posaçëm në historinë tonë, për shkak se është simbol i aspiratave shtetëformuese të popullit maqedonas dhe themel i shtetësisë së Maqedonisë.

**2 gusht viti 1944.** – Në manastirin e Sh. Prohor Pçinskrit është zhvilluar Mbledhja e Parë e KAÇKM-së (Kuvendi Antifashist Nacional për Çlirim të Maqedonisë).

Me pjesëmarrjen e popullit të Maqedonisë në Luftën e Dytë Botërore dhe në Luftën Nacional Çlirimtare kundër fashizmit, populli i Maqedonisë e fitoi lirinë nacionale dhe krijoi shtetin e vet, konstituimi i të cilit është kurorëzuar me Mbledhjen e parë të KAÇKM-së.

Në Mbledhjen e parë të KAÇKM-së janë miratuar nëntë akte ligjvënëse, prej të cilëve katër kanë karakter shtetëror konstituiv. Me këto akte janë ngritur themelet e shtetit të Maqedonisë, si shtet federal në përbërje të Jugosllavisë Demokratike Federative. Në këtë mbledhje solemnisht shpallet konstituimi i Maqedonisë Demokratike Federative.

KAÇKM-ja konstituohet me organin suprem ligjvënës, organin përfaqësues ekzekutiv të popullit dhe organin suprem të Maqedonisë demokratike. Po ashtu është formuar Presidiumi i KAÇKM-së si bartës të kompetencave ekzekutive dhe ligjvënëse, të cilat i realizon ndërmjet mbledhjeve plenare të KAÇKM-së.



Prezidiumi i KAÇKM-së në krye me Metodija Andonov Çenton

Në këtë mbledhje është miratuar Deklarata për të drejtat themelore të qytetarëve, sipas së cilës “të gjithë qytetarët e shtetit federal të Maqedonisë janë të barabarta para ligjeve, pa marrë parasysh kombësinë, racën dhe besimin e tyre”.

Gjuha popullore maqedonase bëhet gjuhë zyrtare e shtetit të Maqedonisë, ndërsa 2 gusht shpallet festë popullore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe shtetit të Maqedonisë, si simbol i të gjitha betejave për çlirim nga robëria shekullore dhe për krijimi të shtetit të lirë të Maqedonisë.

Për ndër të dy evenimenteve të mëdha, të cilat kanë ngjarë në këtë ditë, në linden, në të cilët janë ngritur themelet e shtetësisë dhe pavarësisë së Maqedonisë, 2 gushti është shpallur si festë shtetërore e Republikës së Maqedonisë – Ditë e Republikës.

**14-16 prill viti 1945.** – në mbledhjen e tretë KAÇKM-ja është emërtuar Kuvendi Popullor i Maqedonisë Demokratike Federative. Akti më i rëndësishëm shtetëror juridik i miratuar në këtë mbledhje është formimi i qeverisë së parë, si organ ekzekutiv i shtetit të Maqedonisë (nga marsi i vitit 1946 është riemërtuar Republika Popullore e Maqedonisë). Me këtë është përmbyllur procesi i konstituimit të pushtetit popullor, si dhe afirmimi i pavarësisë shtetërore dhe nacionale të popullit maqedonas.

**31 dhjetor viti 1946.** – Kuvendi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë i zgjedhur në zgjedhje të lira, me votim të drejtpërdrejtë dhe ë fshehtë, e miratoi Kushtetutën e Republikës Popullore të Maqedonisë. Kjo Kushtetutë ka rëndësi të madhe historike dhe politike për Maqedoninë. Republika Popullore e Maqedonisë është definuar si shtet popullor me formë republikane të udhëheqjes, e bashkuar me popujt tjerë të Jugosllavisë dhe republikave të tyre popullore: Republikën Popullore të Serbisë, Republikën Popullore të Malit të Zi, Republikën Popullore të Bosnjë e Hercegovinës, Republikën Popullore të Kroacisë dhe Republikën

Popullore të Sllovenisë, brenda një shteti të përbashkët federal - Republika Federative Popullore e Jugosllavisë (në vitin 1963 u riemërtua në Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë). Sipas Kushtetutës parimi kryesor i organizimit të pushtetit është principi i organizimit kuvendor të pushtetit, gjegjësisht parimi i unitetit në pushtet. Përfaqësuesi i suverenitetit popullor dhe organit suprem të pushtetit në Republikë është Kuvendi Popullor, i cili është bartës i vetëm i pushtetit ligjvënës. Kuvendin Popullor të RPM-së e zgjedhin qytetarët në bazë të të drejtës së përgjithshme, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë me votim të fshehtë dhe për periudhë katërvjeçare.

Kuvendi Popullor, i cili nga viti 1963 është riemërtuar në Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, do të ngel organi më i lartë deri në pavarësimin e Maqedonisë nga RSFJ-ja në vitin 1991. Parimi i barazisë në pushtet, gjegjësisht sistemi i Kuvendit do të jetë parimi themelor i organizimit të pushtetit në Republikë, ndërsa do të ndryshohet shkalla e theksimit të tij, gjegjësisht organizimi dhe struktura e Kuvendit (ndryshimet janë përcaktuar në Ligjin kushtetues për bazat e rreshtimit politik dhe organet e pushtetit të RPM-së nga viti 1952, Kushtetuta e RSM-së nga viti 1963 dhe Kushtetuta e RSM-së nga viti 1964). Pra në këtë periudhë Kuvendi do të jetë njëdhomësh, dydhomësh, tredhomësh, madje edhe pesëdhomësh. Mandati i të deleguarve në Kuvend është i tipit imperativ (me mundësi për revokim), ndërsa mënyra e zgjedhjes së tyre ndryshohet nga sistemi i zgjedhjeve të drejtpërdrejta deri të sistemi i përbërë delegues, si sistem i konstituimit të tërthortë të Kuvendit.

**20 shtator viti 1990.** – Kuvendi i RS të Maqedonisë aprovon 25 amendamente të Kushtetutës së RSM-së nga viti 1974, me çka bëhen ndryshime radikale në sistemin shoqëror-ekonomik dhe politik. Një gjë e tillë e shënon fillimin e tranzicionit të shtetit drejt sistemit të ri parlamentar dhe drejt krijimit të shtetit sovran dhe të pavarur. Mes tjerash me amendamentet kushtetuese mundësohet pluralizëm politik dhe pronësor. Po ashtu bëhet ristrukturim të institucioneve kryesore të shtetit (Kuvendi bëhet njëdhomësh, Këshilli ekzekutiv bëhet Qeveri, ndërsa në vend të Kryesisë kolektive për herë të parë përfshihet funksioni i Kryetarit të Republikës). Sistemi i delegatëve anulohet, ndërsa deputetët në Kuvendin e RSM-së zgjedhen nga qytetarët me vota të drejtpërdrejta dhe të fshehta. Kandidatët për deputetë i propozojnë qytetarët, organizatat politike dhe format tjera të organizimit dhe bashkimit. Një muaj më vonë, Kuvendi e ka miratuar Ligjin për zgjedhje dhe revokim të deputetëve dhe këshilltarëve, që parqet hap të fundit në përgatitjen për zhvillim të zgjedhjeve të para demokratike dhe shumëpartiake.

**11 nëntor viti 1990.** – Në këtë datë në RS të Maqedonisë janë mbajtur zgjedhjet e para të lira demokratike shumë partiake parlamentare. Zgjedhjet janë zhvilluar sipas modelit zgjedhor të mazhorancës, ndërsa territori i Maqedonisë është ndarë në 120 njësi zgjedhore. Në këto zgjedhje kanë marrë pjesë 18 parti politike dhe 43 kandidatë të pavarur dhe janë zgjedhur 120 deputetë në Kuvendin e atëhershëm të Republikës Socialiste të Maqedonisë. Përmes përfaqësuesve të zgjedhur të partive de opsioneve të ndryshme politike, në Maqedoni është krijuar sistemi parlamentar me demokraci pluraliste.

**8 janar viti 1991.** – është konstituuar Kuvendi i parë i Republikës Socialiste të Maqedonisë, i përbërë nga deputetë të 9 partive politike dhe 3 kandidatë të pavarur. Në pajtim me dispozitat e rregullores së përkohshme mbledhjen e drejtoi deputeti më i vjetër, ndërsa kryetar i Kuvendit të RS të Maqedonisë është zgjedhur Stojan Andovi. Kuvendi i parë shumë partiak aktivitetet e veta i drejton kah miratimi i akteve dhe dokumenteve shtetformuese, të cilat qartë e shprehin dëshirën shekullore të popullit të Maqedonisë për ndërtim të shtetit të pavarur dhe sovran. Pastaj ky Kuvend e zgjodhi Kryetarin e parë dhe Qeverinë e parë të Republikës, shpall referendum për pavarësinë dhe miratojë Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, himnin dhe flamurin e saj.

**25 janar viti 1991.** – Në njërën nga seancat e para deputetët e kanë miratuar Deklaratën për sovranitetin e Republikës Socialiste të Maqedonisë, me çka shprehet sovraniteti i Republikës Socialiste të Maqedonisë në pajtim me përcaktimet kushtetuese për pavarësinë dhe integritetin territorial të shtetit të Maqedonisë, si dhe të drejtën e popullit maqedonas për shkëputje (nga ish Jugosllavia). Kjo Deklaratë do të paraqesë bazë për miratimin e Kushtetutës së parë demokratike të Republikës së Maqedonisë.

**27 janar viti 1991.** - Në seancën e Kuvendit për kryetar të parë të RS të Maqedonisë është zgjedh Kiro Gligorovi.

**20 mars viti 1991.** – Kuvendi e zgjedh Qeverinë e parë të RS të Maqedonisë (të emërtuar qeveri eksperte), në krye me dr. Nikola Klusevin.

**7 qershor viti 1991.** – Kuvendi i RS të Maqedonisë miraton 4 amendamente e Kushtetutës së RS të Maqedonisë, mes të cilëve edhe amendamenti për fshirje të atributit “Socialist” para emrit të Republikës Socialiste të Maqedonisë. Prej atëherë republika e bart emërtimin Republika e Maqedonisë.

**6 gusht viti 1991.** – Kuvendi miraton Vendimin për shpallje të referendumi për përcaktim të qytetarëve

për shtet të pavarur dhe sovran. Në këtë vendim është dhënë pyetja, për përcaktim të qytetarëve në referendum: “A jeni për shtetin e pavarur dhe sovran të Maqedonisë me të drejtë për t’u përfshirë në aleanca të ardhshme të shteteve sovraane të Jugosllavisë?”

**8 shtator viti 1991.** - mbahet referendumi për sovranitetin dhe pavarësinë e shtetit të Maqedonisë. Në referendum pozitivisht janë përcaktuar 95,09% nga qytetarët e dalë në referendum, ose 72,16% nga numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote. Për këtë arsye 8 shtatori është shpallur festë shtetërore – Dita e pavarësisë.



*Ftesa për referendum*

**17 shtatori viti 1991.** – Kuvendi i Republikës së Maqedonisë sjell Deklaratën për verifikim të rezultateve të referendumi për konstituim të Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur. Në Deklaratë është theksuar se qytetarët e Republikës së Maqedonisë në mënyrë demokratike kanë shënuar faqe të re të historisë shumëshekullore maqedonase të përmbyllur me sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë. Kjo Deklaratë paraqet vendim formal të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për konstituim të Republikës së Maqedonisë në shtet të pavarur dhe sovran, duke pasur parasysh faktin, se vullneti i qytetarëve i shprehur me referendum nuk kishte karakter vendimmarrës, por vetëm konsultativ.

**17 nëntor viti 1991.** – Kuvendi e shpall Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si akt më të lartë juridik shtetëror, me çka përmbillet procesi i gjatë historik i konstituimit të Republikës së Maqedonisë si shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social. Miratimi i Kushtetutës e shënon fillimin e ndërtimit të rendit të ri kushtetues dhe themelimin e Republikës së Maqedonisë si demokraci parlamentare. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nga viti 1991 është kushtetuta e parë e Maqedonisë, e cila e përcakton parimin e ndarjes së pushtetit të shtetit si vlerë themelore të rendit kushtetues (kushtetutat paraprake të Maqedonisë e njihnin parimin e pushtetit kuvendor ose parimin e unitetit të pushtetit). Sipas Kushtetutës, pushteti shtetëror në Republikën e Maqedonisë ndahet në pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Bartës të pushtetit

ligjvënës është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, që është organ përfaqësues njëdhomësh i qytetarëve, i përbërë nga 120 deri në 140 deputetë (numri i saktë i deputetëve është përcaktuar me ligj dhe deri në vitin 2008 ka qenë 120 deputetë, ndërsa pas këtij viti Kuvendi numëron 123, tre deputetët plotësues zgjedhen nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët janë me punë ose qëndrim të përkohshëm jashtë vendit). Deputetët zgjedhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me vota të fshehta për periudhë katërvjeçare.



Shpallja e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë nga viti 1991.

Nga miratimi i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë janë pranuar gjithsej 32 amendamente, të cilët janë pjesë përbërëse të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (në vitet 1992, 1998, 2001, 2003, 2005, 2009 dhe 2011).

**19 nëntor viti 1991.** – Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Deklaratën për njohje ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur. Në bazë të kësaj Deklarate, Republika e Maqedonisë bëhet anëtare e pothuajse të gjitha organizatave të rëndësishme ndërkombëtare, me të cilat ka bashkëpunuar në mënyrë aktive dhe me sukses: OKB (1993), OBT (1993), OSBE (1995), Këshilli i Evropës (1995), CEFTA (2006) etj. Maqedonia është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (nga viti 2005) dhe në NATO.

**14 shkurt viti 1992.** – Në këtë datë është miratuar Ligji për mbrojtje, sipas së cilit forcat e armatosura – Armata e Republikës së Maqedonisë – janë përgjegjës për mbrojtjen e vendit.

**26 prill viti 1992.** – Kuvendi e miraton Ligjin për njësinë monetare të Republikës së Maqedonisë, me çka shpallet pavarësia monetare dhe aprovohet valuta nacionale – denari i Maqedonisë.

**29 korrik viti 1992.** – Në këtë datë është miratuar Vendimit për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

**11 gushti i vitit 1992.** – Kuvendi e miraton himnin e Republikës së Maqedonisë.

**16 dhe 30 tetor viti 1994.** - Mbahen zgjedhjet e para parlamentare pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë. Në të njëjtën kohë zhvillohen edhe zgjedhjet parlamentare sipas modelit të njëjtë zgjedhor të zbatuar në vitin 1990 (zgjedhjet parlamentare në vitin 1998 realizohen në pajtim me modelin zgjedhor të kombinuar, ndërsa nga viti 2002 zbatohet modeli proporcional).

**16 nëntor viti 2001.** - si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit më 13 gusht 2001, janë bërë ndryshime dhe plotësime të rëndësishme të Kushtetutës, si në Preambulën ashtu edhe në një pjesë të madhe të dispozitave në pjesën normative të saj. Zgjidhjet e vëna në këto amendamente sjellin ndryshime qenësore në sistemin kushtetues dhe juridik të Republikës së Maqedonisë, me qëllim që të fuqizohen proceset e integritit të brendshëm të të gjitha bashkësive etnike pa asimilim dhe krijim të bazës për stabilitet të vazhdueshëm ndëretnik.



Kuvendi i Republikës së Maqedonisë



Ky dokument është punuar në suazat e Projektit "Vendosja dhe Zhvillimi i Institutit Parlamentar" të Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, i kofinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) me mbështetje këshillëdhënëse të Institutit Nacional Demokratik (NDI). Mendimet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC ose NDI.